



KOLEGJI - COLLEGE
PJETËR BUDI
Prishtinë - Prishtina

KOLEGJI "PJETER BUDI"



RR E G U L L O R E PËR PËRGJEGJËSINË DISIPLINORE TË PUNËSUARVE TË KOLEGJIT "PJETER BUDI"

Prishtinë, 2020



Në bazë të nenit 125te Statutit, Bordi Drejtues i Kolegjit "Pjetër Budi", me datë 29.12.2020, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR PËRGJEGJËSINË DISIPLINORE

I. DISPOZITAT THEMELORE

Lënda e Rregullores

Neni 1.

Me Rregulloren për përgjegjësinë disiplinore (në tekstin e mëtejme Rregullorja), të punësuarve të Kolegjit "Pjetër Budi", Prishtinë, (në tekstin e mëtejme: Kolegji "Pjetër Budi"), rregullohet përgjegjësia disiplinore për shkeljen e detyrave të punës.

Format e përgjegjësisë

Neni 2

Të punësuarit i përgjigjen Kolegjit "Pjetër Budi" në formë disiplinore.

Neni 3

I punësuari në punë dhe lidhur me punën ka këto obligime:

1. në mënyrë të rregullt dhe me kohë t'i ekzekutoj të gjitha punët dhe detyrate punës të përcaktuara me Statut, Kontratë të Punës dhe në bazë të përshkrimit të punëve dhe detyrave të punës;
2. të ruaj pasurinë e Kolegjit "Pjetër Budi" dhe mjetet me të cilat ajo disponon dhe ndaj tyre të silltet me përkujdesje dhe si shtëpiak i mirë;
3. që personalisht me ndërgjegje dhe përgjegjësi të plotë t'i kryej detyrat e punës që dalin nga themelimi i marrëdhënies së punës;
4. që punën ta kryejë në kohën e paraparë dhe gjatë kohës së punës mos të largohet nga vendi i punës pa leje paraprake të eprorit;
5. që të vije në punë dhe të dalë nga puna në kohën e përcaktuar për fillimin gjegjësisht përfundimin e orarit të punës;
6. që në rast të pengesës eventuale të ardhjes në punë të lajmëroj eprorin e drejtpërdrejt, më së voni në afatin prej 24 orëve;
7. të ruaj sekretin zyrtar;
8. që rregullisht të përsosë aftësitë, dijen dhe përvojën e punës;
9. që të kultivoj marrëdhënia të mira me të punësuarit e tjerë dhe palët;
10. që me sjelljen e vet brenda vendit të punës, mos të cenojë autoritetin e Kolegjit "Pjetër Budi";
11. që me ndërgjegje t'i ushtrojë funksionet udhëheqëse;
12. t'iu ofrojë ndihmë profesionale praktikantëve dhe punëtorëve të rinj;
13. që në punën e përditshme t'i zbatojë vendimet dhe e organeve drejtuese të Kolegjit "Pjetër Budi";



II. PËRGJEGJËSIA PËR SHKELJEN E DETYRAVE TË PUNËS

Neni 4

Përgjegjësia për shkeljen e detyrave të punës në punë dhe lidhur me punën, i nënshtrohen të gjithë të punësuarit, pa marrë parasysh autorizimet dhe përgjegjësitë të cilat i kanë.

Neni 5.

Për çdo shkelje të detyrave të punës, më parë vërtetohet vendi dhe koha. Nocioni i fajësisë, dashja dhe pakujdesia janë vërtetim i përgjegjësive disiplinore të punëtorit.

Neni 6.

Punëtori përgjigjet vetëm për shkeljen e detyrave të punës të cilat janë të parapara me ligjet në fuqidihe me këtë Rregullore.

Përcaktimi i përgjegjësive disiplinore

Faji

Neni 7.

Punëtori i cili është i aftë të kuptoj rëndësinë e sjelljeve të veta është përgjegjës në mënyrë disiplinore, nëse shkeljen e detyrave të punës e bënë me fajin e vet. Punëtori është fajtor nëse shkeljen e detyrave të punës e bënë me paramendim ose nga pakujdesia.

Paramendimi

Neni 8.

I punësuarit bënë shkeljen e detyrave të punës me paramendim, kur ka qenë i vetëdijshëm për shkeljen dhe ka dëshiruar shkeljen e saj apo në rastin kur ka qenë i vetëdijshëm që si pasojë e sjelljeve të tija mund të shkaktohet shkelja e detyrave të punës kështu që ka pranuar shkeljen e saj.

Pakujdesia

Neni 9.

Punëtori bënë shkeljen e detyrave të punës nga pakujdesia në rastin kur ka qenë i vetëdijshëm që deri tek shkelja e detyrave të punës mundë të vije, mirëpo konsideron që në rastin konkret nuk do të vjen deri tek shkelja apo do të mundet të njëjtën ta evitoj, ose në rastin kur nuk ka qenë i vetëdijshëm për mundësin e paraqitjes së shkeljes së detyrave të punës.



III. PËRCAKTIMI I SHKELJEVE TË DETYRAVE TË PUNËS

Neni 10.

Punëtori ka përgjegjësi disiplinore për shkelje të detyrave të punës, të cilën e ka shkaktuar me fajin e vet.

Shkeljet e detyrave të punës mund të jenë të lehta dhe të rënda.

Shkeljet e lehta të detyrave të punës

Neni 11.

Shkeljet e lehta të detyrave të punës janë:

1. ardhja në punë me vonesë ose largimi nga vendi i punës gjatë dhe para kryerjes së orarit të punës, pa lejen e prororit të drejtpërdrejt;
2. moskryerja e detyrave të punës me kohë me çka shkaktohet mosrealizimi me kohë i plan programit të punës;
3. refuzimi i bashkëpunimit me punëtorët e tjerë;
4. sjellja jo korrekte dhe jo njerëzore gjatë kohës së punës me punëtorët e tjerë dhe me studentë;
5. kryerja e punëve private gjatë kohës së punës;
6. shkelja e të gjitha detyrave të tjera të parapara, e që nuk paraqesin shkelje të rënda të detyrave të punës në kuptim të kësaj Rregulloreje.

Shkeljet e rënda të detyrave të punës

Neni 12.

Shkelje të rënda të detyrave të punës janë:

1. moskryerja dhe kryerja pa ndërgjegje ose me pakujdesi e punëve dhe detyrave të punës;
2. keqpërdorimi i pozitës dhe tejkalimi i autorizimeve të dhëna;
3. zbulimi i sekretit zyrtar ose të dhënave të tjera, të parapara me ligj ose me aktet e përgjithshme juridike;
4. keqpërdorimi i të drejtës në pushim mjekësor;
5. pengimi i punëtorëve në procesin e punës;
6. përdorimi i pa autorizuar i mjeteve të besuara për kryerjen e detyrave të punës;
7. refuzimi i kryerjes së punëve apo udhëzimeve nga udhëheqësi i drejtpërdrejt;
8. ardhja në punë në gjendje të dehur ose konsumimi i alkoolit dhe mjeteve të tjera narkotike gjatë kohës së punës;
9. refuzimi i punëtorit që t'i nënshtrohet kontrollit mjekësor, me qëllim të vërtetimit të sasisë së konsumuar të alkoolit në gjak, por edhe të narkotikëve të tjerë;
10. marrja e dhuratave ose gjerave të tjera me vlerë në lidhje me punën si dhe ndërmjetësimi e dhënia e dhuratave personave të tjerë në dëm të Kolegjit "Pjetër Budi";
11. vënia në lajthim e personit të autorizuar që me nënshkrimin e vetë apo vulën të vërtetojë diçka të pa vërtetë;



12. përsëritja e shkeljeve të lehta të detyrave të punës;
13. mungesa nga puna, pa arsye 5 (pesë) ditë pandërprerë, ose 7 (shtatë)ditë me ndërprerje gjatë vitit kalendarik;
14. përdorimi i vulës dhe vulës katrore jashtë kompetencave dhe autorizimeve;
15. moslajmërimi i fillimit të shfrytëzimit të pushimit mjekësor në afatin prej 24 orëve.
- 16.kur sipas vendimit përfundimtar të Gjykatës, i punësuari duhet të shkoj në burg për periudhën më shumë se 6 (gjashtë) muaj;
- 17.marrëdhënia amorale gjatë kohës së punës si dhe
- 18.çdo shkelje tjetër e cila sipas dispozitave ligjore në fuqi, paraqet shkelje të rëndë të detyrave të punës.

IV. MASAT DISIPLINORE

Neni 13.

Për shkeljen e detyrave të punës, punëtorit mund të i shqiptohet njëra prej këtyre masave disiplinore;

1. Vërejtje me shkrim;
2. Dënim me të holla;
3. Largimi i përkohshëm nga puna-suspendimi
4. Ndërprerja e marrëdhënies së punës-pushimi i kontratës së punës;

Neni 14.

Vërejtja me shkrim mund t'i shqiptohet punëtorit, për shkelje të lehtë të detyrave të punës, të përcaktuara me këtë Rregullore. Kjo masë disiplinore ekzekutohet me publikimin e Vendimit në tabelën e shpalljeve.

Neni 15.

Dënimi me të holla mund të shqiptohet më së shumti në lartësinë prej 30% nga paga mujore, në kohëzgjatje prej 1 (një) e maksimumi gjerë në 3 (tre) muaj. Si bazë për përcaktimin e lartësisë së dënimit në të holla merret shkelja e detyrave të punës dhe paga për muajin për të cilin është shqiptuar masa disiplinore.

Neni16.

Dënimi në të holla, punëtorit mund të i shqiptohet për disa shkelje të lehta të detyrave të punës si dhe për të gjitha shkeljet e rënda, për të cilat me këtë Rregullore nuk shqiptohet masa e ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

Shkëputja e kontratës së punës-ndërprerja e marrëdhënies së punës

Neni 17.

Shkëputja e kontratës së punës -ndërprerja e marrëdhënies së punës të punësuarit i bëhet në rastet si vijon:

- 1.nëse i punësuari nuk i kryen ose i kryen në mënyrë jo të rregullt obligimet e përcaktuara me ligj, përshkrimin e vendit të punës dhe kontratë të punës;



- 2.nëse është vërtetuar se i punësuari nuk ka dijeni dhe aftësi të nevojshme për kryerjen e punëve në të cilat punon;
- 3.nëse i punësuari me faj e bënë shkeljen e detyrave të punës ,
- 4.sjellja e natyrës aq të rëndë pas së cilës do të ishte e paarsyeshme që të pritet të vazhdoj marrëdhënia e punës edhe më tej;
- 5.nëse i punësuari në punë ose lidhur me punën kryen vepër penale ;
- 6.nëse i punësuari mungon nga puna paarsye 5 (pesë) ditë pune pa ndërprerje ose 7(shtatë) ditë pune me ndërprerje brenda një viti;
- 7.nëse i punësuari e keqpërdor pushimin mjekësor ;
- 8.kur sipas vendimit përfundimtar të gjykatës,i punësuari duhet të shkoj në burg për periudhën më shumë se 6 muaj;
9. kundërshtimi i paarsyetur për kryerjen e detyrave të përcaktuara me kontratën e punës dhe përshkrimin e vendit të punës;
- 10.zbulimi i fshehtësive afariste ;
- 12.përdorimi i drogave dhe alkoolit në punë;
- 13.gabimet e përsëritura të cilat si të tilla çrregullojnë ecurinë normale të marrëdhënies së punës.

Neni 18.

Shkëputja e kontratës së punës – ndërprerja e marrëdhënies së punës ekzekutohet kur merr Vendimi merr formën e prerë.

Neni 19.

Largimi i përkohshëm nga puna-suspendimi, shqiptohet për të gjitha shkeljet e rënda të detyrave të punës.

Neni 20.

Para se të shqiptohet masa disiplinore për shkak të shkeljes së detyrave të punës duhet të merret parasysh veçanërisht pesha e shkeljes dhe pasojat e sajë, shkalla e përgjegjësisë së punëtorit, rrethanat në të cilat është bërë shkelja, sjellja dhe puna e mëhershme e punëtorit dhe rrethanat e tjera, të cilat ndikojnë në shqiptimin e llojit dhe lartësisë së masës.

V. ORGANET DISIPLINORE

Neni 21.

Organet disiplinore të Kolegjit "Pjetër Budi", të cilat vendosin për përgjegjësinë dhe shqiptojnë masa disiplinore në shkallë të parë është Komisioni disiplinor.

Neni 22.

Komisioni disiplinori Kolegjit "Pjetër Budi", vendos për përgjegjësinë disiplinore të punëtorit, për shkeljen e bërë të detyrave të punës dhe shqipton masat: vërejtje me shkrim, dënim në të holla, ndërrimin e vendit të punës dhe suspendimin e përkohshëm.

Neni 23.



Komisioni Disiplinor vendos për përgjegjësinë disiplinore të punëtorit për shkeljen e detyrës së punës, për të cilën shqiptohet masa disiplinore ndërprerje e marrëdhënies së punës, për shkelje të rënda të detyrave të punës.

Neni 24.

Komisioni Disiplinor përbëhet prej 3 anëtarëve: Kryetarit dhe dy anëtarëve.

Neni 25.

Nëse para komisionit disiplinor vërtetohet se i punësuar ka shkaktuar shkelje të lehtë ose vërtetohen rrethanat lehtësuese të cilat mundë të ndikojnë në shqiptimin e masës më të lehtë, komisioni disiplinor mundet që punëtorit ti shqipton masën vërejtje me shkrim apo dënim me të holla.

Neni 26.

Bordi Drejtues i Kolegjit "Pjetër Budi", është organ i shkallës së dytë, i cili vendos për përgjegjësinë disiplinore të stafit akademik të Kolegjit "Pjetër Budi".

Neni 27.

Organet disiplinore i emëron Bordi Drejtues i Kolegjit "Pjetër Budi" dhe janë të detyruara që ti paraqesin Raportet vjetor për masat e shqiptuara disiplinore. Kryetari apo anëtarët e komisionit disiplinor nuk mundë të zgjidhet personi i cili vendos në shkallë të dytë.

VI. PROCEDURA DISIPLINORE

Fletëparaqitja disiplinore

Neni 28.

Çdo punëtor ka të drejtë të iniciojë fillimin e procedurës disiplinore për shkeljen e bërë të detyrave të punës për cilindo punëtor tjetër.

Punëtori vepron në pajtim me detyrën e vetë edhe kur e lajmëron udhëheqësin e drejtpërdrejt për shkeljen e bërë.

Punëtori me autorizime dhe përgjegjësi të veçanta është i obliguar që për shkeljen e bërë të detyrave të punës, brenda afatit prej 8 (tetë) ditëve, prej ditës së marrjes në dijeni për shkeljen e detyrave të punës dhe kryesin, të lajmërojë Komisioni disiplinortëKolegjit "Pjetër Budi".

Neni 29.

Procedura disiplinore fillon me kërkesën eKomisionit të Disiplinor

Neni 30.

Kërkesa për fillimin e procedurës bëhet me shkrim dhe përmban shënimet e duhura për caktimin e shkeljes dhe përgjegjësinë e punëtorit.



Kërkesa për fillimin e procedurës i dërgohet: punëtorit, ndaj të cilit është iniciuar procedura disiplinore dhe organit disiplinor.

Procedura para Komisionit disiplinor

Neni 31.

Komisioni Disiplinor është i detyruar që kërkesën për fillimin e procedurës ta shqyrtojë dhe ta fillojë procedurën në afatin prej 15 ditësh, nga dita e parashtrimit të kërkesës.

Neni 32.

Shqyrtimin e hapë Kryetari i Komisionit disiplinor i cili konstaton se a janë të pranishëm të gjithë të ftuarit.

Me shqyrtim udhëheqë Kryetari i Komisionit Disiplinor.

Kryetari kujdeset që gjatë shqyrtimit të ndriçohen të gjitha faktet relevante, që mundësojnë marrjen e vendimit të drejtë dhe të ligjshëm.

Kryetari u jep dhe ua merr fjalën palëve dhe dëshmitarëve, parashtron pyetje dhe kërkon sqarime si dhe e shpallë vendimin e Komisionit.

Pyetje mundë të parashtrojnë edhe anëtarët e Komisionit Disiplinor.

Neni 33.

Shqyrtimi para Komisionit Disiplinor fillon me leximin e kërkesës për inicimin e procedurës, pas së cilës ftohet punëtori që ta paraqes mbrojtjen e vet.

Pas mbrojtjes së punëtorit, ftohen dëshmitarët që të japin deklaratat e tyre. Pas dëgjimit të dëshmitarëve, lexohen shkresat dhe deklaratat e dëshmitarëve që nuk janë të pranishëm.

Neni 34.

Komisioni Disiplinor mund të merr një nga këto Vendime:

1. Për lirim të punëtorit nga përgjegjësia disiplinore;
2. Për ndërprerjen e procedurës;
3. Për shqiptimin e njëjës prej masave disiplinore të përcaktuara në nenin 13 të kësaj Rregulloreje.

Neni 35.

Komisioni Disiplinor merr vendim për lirim nga përgjegjësia nëse vërtetohet se:

1. Veprimi për të cilin është iniciuar procedura disiplinore, nuk paraqet shkelje të detyrave të punës, të paraparë me këtë Rregullore;
2. Shkeljen e detyrave të punës, punëtori nuk e ka kryer me fajin e vet dhe nëse ekzistojnë rrethana të tjera, të cilat përjashtojnë përgjegjësinë e tij;
3. Punëtori nuk e ka bërë shkeljen e cila i ngarkohet;

Neni 36.

Vendimi i Komisionit Disiplinor merret me shumicë votash.



Për vendosje-votim mbahet procesverbali i posaçëm.
Vendimin e kumton Kryetari i Komisionit Disiplinor.

VII. SHFRYTËZIMI I TË DREJTËS NË KUNDËRSHTIM DHE PROCEDURA SIPAS KUNDËRSHTIMIT

Neni 37.

Kundërshtimi kundër vendimit të organit disiplinor, mund t'i ushtrohet Bordit Drejtues të Kolegjit "Pjetër Budi" në afatin prej 8 ditësh, nga punëtori, të cilit i është shqiptuar masa disiplinore
Afati për parashtrimin e kundërshtimit, rrjedhë që nga data e dorëzimit të vendimit.

Neni 38.

Në mbledhjen e Bordit Drejtues të Kolegjit "Pjetër Budi", punëtori mundet që gojarisht të arsyetojë kundërshtimin e vetë.

Neni 39.

Pas shqyrtimit të kundërshtimit, mundë të merret, një prej këtyre vendimeve:
1. Refuzohet kundërshtimi dhe vërtetohet Vendimi për përgjegjësin e punëtorit.
2. Aprovohet kundërshtimi i punëtorit dhe shqiptohet masë më e lehtë.
3. Ndërprehet procedura për shkak të vjetërsimit dhe
4. Aprovohet kundërshtimi dhe punëtori lirohet nga përgjegjësia.

Neni 40.

Vendimi merret me shumicë votash të pranishmëve.
Vendimi me shkrim i dërgohet punëtorit dhe parashtruesit të kundërshtimit, më së voni, në afatin prej 8 ditësh pas miratimit, me udhëzime juridike që mundë t'i drejtohet gjykatës kompetente për mbrojtjen e të drejtave të veta.

VIII. ZBATIMI I MASËS SË SHQIPTUAR

Neni 41.

Masa e vërejtjes me shkrim zbatohet me publikimin e saj në tabelën e shpalljeve.
Masa e ndërrimit të vendit të punës dhe suspendimi, zbatohet, prej ditës së dorëzimit të vendimit.
Masa e ndërprerjes së marrëdhënies së punës zbatohet prej ditës së dorëzimit të vendimit të plotfuqishëm për ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

Neni 42.

Vendimi për shqiptimin e masës bëhet i plotfuqishëm
- kur të kalojë afati për kundërshtim, e kundërshtimi nuk është parashtruar,
- kur organi i shkallës së dytë merr vendim sipas kundërshtimit, me të cilin vërtetohet apo ndryshohet vendimi i shkallës së parë, nëse kundërshtimi është brenda afatit.



IX. SUSPENDIMI I PUNËTORIT NGA VENDI I PUNËS

Neni 43.

Punëtori në pajtim me ligjin dhe këtë Rregullore, mundëpërkohësisht të largohet nga puna dhe detyrat e punës që i kryen dhe të caktohet në punët të tjera ose të suspendohet në këto raste:

1. Nëse është gjetur në kryerjen e shkeljeve të rënda të detyrave të punës;
2. Nëse është filluar procedura kundër tij, për mospërbushjen e detyrimeve të veta nga marrëdhënia e punës dhe rëndë i ka shkelur interesat e punëtorëve të tjerë;
3. Nëse kundër punëtorit është filluar procedura penale, për shkak të veprës penale të kryer në punë ose lidhur me punën.

Neni 44.

Nëse kundër punëtorit caktohet paraburgimi, punëtori largohet nga puna.

Neni 45.

Vendimin për largimin e punëtorit nga puna dhe largimin nga punët dhe detyrat e punës e merr Komisioni disiplinori Kolegjit "Pjetër Budi", apo Rektori i Kolegjit, varësisht nga pozita në të cilën është i punësuar.

Neni 46.

Kundër Vendimit për largim, punëtori ka të drejtë të parashtrojë kërkesë për mbrojtjen e të drejtave të veta në afatin prej 8 ditësh, Bordit Drejtues të Kolegjit "Pjetër Budi".

X. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 47.

Ndryshimi dhe plotësimi i kësaj Rregulloreje, bëhet në të njëjtën mënyrë dhe sipas të njëjtës procedurë që është aprovuar.

Neni 48.

Kjo Rregullore hunë në fuqi ditën e miratimit.

**Kryetari i Bordit
Drejtues**

Besim AJETI